

Në zbatim të nenit 43, të Statutit të BSPSH-së, në ditën e dytë të Kongresit, në datën 7 Shtator 2014, u mbajt mbledhja e parë e zgjeruar e Asamblesë Kombëtare ku morën pjesë dhe drejtuesit e seksioneve më aktive të BSPSH në ambientet e Hotel “ Tropikal” në Durrës. Presidenti i BSPSH-së prezantoi konstituimin dhe përbërjen e organeve vendimmarrëse të Asamblesë, të Këshillit Kombëtar, të Komisionit të Interpretimit dhe Zbatimit të Statutit dhe të Komisionit të kontrollit financiar. Punimet e Asamblesë, bazuar në Statutin e BSPSH-së, u drejtuan nga Presidenti, nga drejtuesi i federatës më të përfaqësuar dhe drejtuesi i rajonit më të përfaqësuar. Në vijim u bë zgjedhja e komisionit të përhershëm të votimit të Asamblesë Kombëtare, me 3 anëtarë. Në zbatim të nenit 13 të Statutit, Presidenti prezantoi përbërjen e Asamblesë së re Kombëtare, me pjesëmarrjen e 101 anëtarëve, ku 45 mandate janë për federatat, 45 mandate janë për rajonet dhe 11 për organet qendrore të BSPSH-së. Më pas Asambleja Kombëtare, bazuar në nenin 15, 25 dhe 36, të Statutit të BSPSH-së miratoi konstituimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të BSPSH-së, si më poshtë:



**Nga federatat:** Të gjithë kryetarët e federatave që kanë plotësuar dokumentacionin e aderimit në BSPSH-së. Zëvendëskryetarët e federatave janë kandidatë për Këshillin Kombëtar.

**Nga rajonet:** Të gjithë kryetarët e strukturave rajoneve dhe lokale të BSPSH-së, sipas përcaktimeve të nenit 25 dhe 27 të Statutit. Në zbatim të nenit 27 të Statutit strukturat lokale të BSPSH-së, të cilat nuk kanë krijuar mbi 5 seksione, përfaqësuesi i kësaj strukture është anëtar i Këshillit Kombëtar pa të drejtë vote.

**Nga struktura qendrore e BSPSH-së:** Zëvendëspresidenti i BSPSH-së, Sekretari Organizativ, Sekretari për marrëdhëniet me publikun, Sekretari për marrëdhëniet me jashtë, koordinatorët, i Forumit të Gruas dhe i Forumit të Rinisë, Kryetari i Komisionit të kontrollit financiar.

**Nga seksionet e federative:** Sipas ndryshimeve të nenit 15, Presidenti i BSPSH-së ka të drejtë t'i propozojë Asamblesë deri në 5 anëtarë për Këshillim Kombëtar nga radhët e kryetarëve të seksioneve më aktivë.

Me propozim të Presidentit z. Gëzim Kalaja, Asambleja Kombëtare miratoi kandidatët për Komisionin e interpretimit dhe zbatimit të Statutit. Komisioni do të përbëhet nga 5 anëtarë: 2 nga federatat, Novrus Kaptelli, Jonuz Xhetani, 2 nga rajonet, Albina Peppo, Gani Lami. Bazuar në Statutin e BSPSH-së kryetar i këtij Komisioni është Sekretari Organizativ. Sipas detyrimeve statuore u bë miratimi i Komisionit të kontrollit financiar, i cili përbëhen me nga një përfaqësues nga çdo federatë dhe nga një përfaqësues i BSPSH-së i cili emërohet nga Presidenti dhe kryen funksionet e kryetarit të Komisionit. Në zbatim të procedurave, pas konstituimit të organeve vendimmarrëse, me propozim të Presidentit u bë votimi për Zëvendëspresidentin e BSPSH-së, zotin Sami Kariqi dhe Sekretarin Organizativ, zotin Koço Jani të cilët u miratuan unanimitisht nga Asambleja Kombëtare. Bazuar në kompetencat e nenit 24, Presidenti i BSPSH-së, në fund të mbledhjes emëroi personelin e departamenteve dhe forumeve përkatëse.